



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

N.SH. "Cube"
Pronar: Kreshnik Ceka
OSHP "CUBE TV"
Rr/Nazim Gafurri nr.66
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KPM-2013/ 07
Ref: 1301/196/KPM/ni

VENDIM

lidhur me licencimin e ofruesit të shërbimeve programore "CUBE TV" – Fushë Kosovë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për distribuimin kabllor të programeve radiotelevizive në Kosovë (CIMC 2007/04), ka hyrë në fuqi më 06.07.2007. Ndërsa, në bazë të Nenit 16 të Rregullores CIMC 2007/04, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore, të cilët do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe të cilat programe do të transmetohen vetëm përmes operatorëve kabllorë.
3. Më 7 dhjetor 2012, kandidati për Ofrues të Shërbimeve Programore "CUBE TV", ka paraqitur aplikacionin për Licencë të KPM-së.

Arsyetim

4. Në bazë të nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore do të rregullohen sikurse subjekte transmetuese.
5. Kandidati për licencë të KPM-së "CUBE TV", në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhëna e nevojshme për Licencë të KPM-së, për të ofruar shërbime programore në pajtueshmëri me Nenin 16 të Rregullores. CIMC 2007/04.
6. Komisioni i Pavarur për Media, vlerëson se kandidati "CUBE TV" ka ofruar informacione të mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Informacionet e ofruara mund të konsiderohen si informacione bindëse lidhur me skemën programore në përgjithësi, duke paraqitur një strukturë të qartë organizative, informacione rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve programore.

7. Neni 22 paragrafi 2, i Ligjit për KPM përcakton: *Licenca e transmetimit mund t'i lëshohet vetëm personit juridik që përmbush kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe kritereve të cilat KPM-ja mund t'i përcaktojë sipas një procedure të drejtë dhe të hapur të konkurrimit.*
8. Gjithashtu, neni 22 paragrafi 3, përcakton: *Licenca e transmetimit nuk i lëshohet ose nuk do të vazhdoj t'i jepet: 3.1. partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individi i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike.*
9. Përmbajtja e skemës programore ashtu siç e cekë edhe kandidati ne piken 5.1. do te jetë me karakter fetarë. Prandaj, KPM vlerëson se karakteri i programit te kandidatit për licencë të Ofruesve të shërbimeve Programore është në kundërshtime Ligjin e KPM-së përkatësisht nenit 22 paragrafi 2, si dhe nenit 22 paragrafi 3, pika 1.
10. KPM, vlerëson se ofruesi i shërbimeve programore "CUBE TV" nuk i përmbush kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

Vendim

11. Komisioni i Pavarur për Media, konkludon se "CUBE TV", ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe nuk ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve përmes sistemit kabllor.
12. Komisioni i Pavarur për Media konkludon se karakteri i programit te kandidatit për licencë të Ofruesve të shërbimeve Programore është në kundërshtim me Ligjin e KPM-së përkatësisht nenit 22 paragrafi 2, si dhe nenit 22 paragrafi 3, pika 1.
13. Komisioni i Pavarur për Media, vendosë që, ofruesit të shërbimeve programore "CUBE TV", me seli në Fushë Kosovë, t'i refuzoj kërkesën për licencë për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore në Republikën e Kosovës, pasi që kërkesa e kandidatit është në kundërshtim me Ligjin e KPM-së.

Lëshimi i Vendimit

14. Këtë vendim e lëshon KPM.

Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



28.12.2012
datë